

TAP

Trans Adriatic Pipeline



VNMS Shqipëri SEKSIONI 5 – Stili dhe metodologjia e VNMS

 	Faqa 2 nga 22					
	Kodi Zonal	Kodi i Kompjut erit	Kodi i Sistemit	Kodi i Disc.	Lloji i Doku mentit	Numri i Serisë
Titulli i Projektit:	Gazsjellësi Trans Adriatik – TAP					AAL00-ERM-641-Y-TAE-1007 Rish.: 03
Titulli i Dokumentit:	VNMS Shqipëri					
	SEKSIONI 5 – Stili dhe metodologjia e VNMS					

PËRMBAJTJA

5	PËRQASJA DHE METODOLOGJIA E VNMS	3
5.1	Hyrje dhe Vështrim i Përgjithshëm mbi Procesin e VNMS	3
5.1.1	Kërkesat e VNMS	3
5.1.2	Legjislacioni dhe Standardet e VNMS	3
5.2	Angazhimi i Palëve të Interesit	4
5.3	Studimi për vlerësimin e gjendjes (<i>Scoping</i>)	5
5.3.1	Konsideratat e Përgjithshme	5
5.3.2	Vlerësimi Teknik	5
5.3.3	Vlerësimi Hapësinor	5
5.3.4	Vlerësimi Kohor	6
5.4	Raporti i VNMS	7
5.4.1	Objektivat	7
5.4.2	Fazat dhe Hapat e VNMS	8
5.5	Metodologjia Bazë e Studimit	12
5.5.1	GIS, Hedhja në Hartë dhe Treguesit	12
5.5.2	Metodologjitë Tematike Specifike	12
5.6	Konsideratat e VNMS në Planifikimin dhe Hartimin e Projektit	12
5.7	Metodologjia e Vlerësimit të Ndikimeve	14
5.7.1	Konsiderata të Përgjithshme	14
5.7.2	Parashikimi i Pasojave	15
5.7.3	Vlerësimi i Rëndësisë	16
5.7.4	Zbutja	18
5.7.5	Vlerësimi i pasojave të mbetura (Reziduale)	18
5.7.6	Akumulimi i Pasojave	19
5.7.7	Ndikimet Ndërkufitare	20
5.7.8	Menaxhimi dhe Monitorimi	20
5.8	Përballja me Pasiguritë dhe Vështirësitë e Hasura gjatë Ndërmarrjes së VNMS-së	20
5.8.1	Konsiderata të Përgjithshme	20
5.8.2	Vështirësitë dhe Pasiguritë në lidhje me Kushtet Bazë	21
5.8.3	Evoluimi i Hartimit të Projektit	21
5.8.4	Saktësia e Parashikimit të Ndikimeve dhe Efektiviteti i masave Zbutëse	22
5.8.5	Menaxhimi i Pasigurisë	22

LISTA E FIGURAVE

Figura 5.4-1	Skema e Procesit të VNM	9
Figura 5.7-1	Vlerësimi i Rëndësisë	17

LISTA E KUADRATEVE

Kuadrati 5.3-1	Përkufizimet e BERZH për Zonat e Ndikimit	6
Kuadrati 5.7-1	Rëndësia e Ndikimeve Reziduale	19

  <small>Trans Adriatic Pipeline</small>	Faqa 3 nga 22					
	Kodi Zonal	Kodi i Kompjut erit	Kodi i Sistemit	Kodi i Disc.	Lloji i Doku mentit	Numri i Serisë
Titulli i Projektit:	Gazsjellësi Trans Adriatik – TAP					AAL00-ERM-641-Y-TAE-1007 Rish.: 03
Titulli i Dokumentit:	VNMS Shqipëri					
	SEKSIONI 5 – Stili dhe metodologjia e VNMS					

5 PËRQASJA DHE METODOLOGJIA E VNMS

5.1 Hyrje dhe Vështrim i Përgjithshëm mbi Procesin e VNMS

Ky seksion përmbledh statet kyçe për procesin e VNMS-së të ndërmarrë nga TAP AG në Shqipëri. Si i tillë, ai paraqet përjasjen që është adoptuar për zbatimin e kësaj VNMS-je dhe përcakton metodologjinë që është përdorur për grumbullimin e të dhënave dhe vlerësimin e ndikimeve. Përjasje paralele janë përdorur në vendet e tjera që përshkohen nga gazsjellësi TAP, *d.m.th.* në Greqi dhe Itali.

5.1.1 Kërkesat e VNMS

Ndërsa korniza rregullatore shqiptare i referohet vetëm Vlerësimin të Ndikimit në Mjedis (VNM), TAP AG po sheh edhe ndikimet sociale të Projektit sipas praktikave ndërkombëtare më të mira. Përmes procesit të Vlerësimin të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS), TAP AG identifikon, adreson dhe menaxhon të gjitha ndikimet, rreziqet dhe mundësitë sociale, mjedisore dhe të trashëgimisë kulturore në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse.

Ashtu siç përshkruhet në *Seksionin 3*, krahas standardeve lokale shqiptare, TAP AG ka përzgjedhur Kërkesat e Performancës (KP) të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për të shërbyer si standard për të siguruar që ndikimet e pafavorshme mbi njerëzit, të drejtat e tyre, mjetet e tyre të jetesës, kulturën dhe mjedisin e tyre të shmangen ose, kur shmangia nuk është e mundur, të minimizohen, të zbuten, të zëvendësohen dhe/ose të kompensohen. Kjo përjasje gjithashtu siguron përputhshmëri me Direktivat e Bashkimit Evropian (BE) dhe më tej me kërkesat e Standardeve të Performancës (SP) të Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe institucioneve të tjera financiare ndërkombëtare të projekteve (IFI) të cilët u referohen këtyre standardeve (p.sh. Equator Principles IFI). TAP AG, është angazhuar t'i përmbushë parimet e mësipërme dhe kërkesat e KP-ve dhe e ka ekspozuar këtë në një dokument politikash mbi VNMS-në për Projektin.¹

5.1.2 Legjislacioni dhe Standardet e VNMS

Legjislacioni dhe standardet përkatëse shqiptare, të BE-së dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit dhe të njerëzve u rishikuan gjatë hartimit të kritereve të rëndësisë për VNMS-në. Shumë instrumente legjislative përcaktojnë standardet e performancës mjedisore dhe të pritshmërive për cilësinë mjedisore të ambientit që lidhen me Projektin. Ato janë përdorur sipas rastit për të hartuar kriteret e rëndësisë në ndikim (shiko *Shtojcën 5*).

Për disa aspekte mjedisore dhe sociale, kërkesat që përmbahen në Ligjin Shqiptar dhe në standardet ndërkombëtare janë të shprehura në terma cilësore dhe mbështeten në gjykimin profesional për vlerësimin e rëndësisë. Në këto raste, për të hartuar kriteret e rëndësisë së ndikimeve, është përdorur rishikimi i udhëzuesit të publikuar, opinionet e ekspertëve dhe komentet nga konsultimi me palët e interesuara gjatë fazës së vlerësimi të gjendjes (*scoping*).

¹ <http://www.trans-adriatic-pipeline.com/tap-project/health-safety-and-environment/corporate-social-responsibility/>

 	Faqa 4 nga 22					
	Kodi Zonal	Kodi i Kompjut erit	Kodi i Sistemit	Kodi i Disc.	Lloji i Doku mentit	Numri i Serisë
Titulli i Projektit: Gazsjellësi Trans Adriatik – TAP Titulli i Dokumentit: VNMS Shqipëri SEKSIONI 5 – Stili dhe metodologjia e VNMS	AAL00-ERM-641-Y-TAE-1007 Rish.: 03					

5.2 Angazhimi i Palëve të Interesit

Si pjesë e procesit të VNMS-së, angazhimi i palëve të interesit u ndërmor për t'u përpatur me kërkesat shqiptare të VNM-së dhe RP10 të BERZH-it mbi *“Publikimin e Informacionit dhe Angazhimin e Palëve të Interesuara”*. RP10 përcakton kërkesat për përkrahësit e projektit:

“... për identifikimin e palëve të interesit që mund të preken nga projekti, publikoni informacion të mjaftueshëm rreth çështjeve dhe ndikimeve që dalin nga projektet dhe konsultohuni me palët e interesit në mënyrë kuptimplotë dhe të përshtatshme nga ana kulturore”.

Prandaj, TAP AG ka përcaktuar një strategji¹ për palët e interesit dhe ka përgatitur dhe po zbaton planin përkatës për angazhimin e palëve të interesuara (SEP, TAP-FEED-AL-EIA-REP-7009). Ky plan ka ofruar një kornizë sistematike për angazhimin e Projektit me palët e interesit kombëtare, rajonale dhe lokale si dhe angazhimin e tij me palët ndërkombëtare të interesit.

Qëllimet kryesore të PAPI-it (Plani për Angazhimin e Palëve të Interesit) janë të sigurojë që:

- Njerëzve të prekur nga Projekti dhe palëve të tjera të interesit t'u sigurohet informacion i përshtatshëm dhe në kohë;
- Palëve të interesit t'u jepen mundësi të mjaftueshme për t'u dhënë zë opinionëve dhe shqetësimeve të tyre; dhe
- Opinioni i palëve të interesit të ndikojë mbi vendimet e Projektit.

TAP AG ka informuar dhe ka angazhuar palët e interesit përmes një shumëllojshmërie mekanizmesh. Këto përfshijnë një turne për vlerësimin e gjendjes në teren (*Scoping*) në bashkitë përgjatë gjurmës së propozuar (shiko *Seksionin 7*), përfshirjen e palëve të interesit në hartimin e studimit bazë të VNMS-së, konsultimin me palët e interesit mbi çështjet kyçe me rëndësi për Projektin dhe VNMS-në, publikimin e informacionit rreth Projektit, takime formale dhe joformale me palët e interesit dhe prezantimin e draftit të VNMS-së në përpunje me kërkesat kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në *Seksionin 7* dhe *Seksionin 8* janë ofruar informacionet e mëtejshëm në lidhje me zbatimin e PAPI-it dhe konsultimin publik dhe statusor me palët e interesit duke përfshirë një përmbledhje të çështjeve dhe shqetësimeve të ngritura nga palët e interesit dhe se si projekti iu është përgjigjur dhe i ka trajtuar ato.

¹ <http://www.trans-adriatic-pipeline.com/tap-project/health-safety-and-environment/stakeholder-engagement/>

 	Faqa 5 nga 22					
	Kodi Zonal	Kodi i Kompjuterit	Kodi i Sistemit	Kodi i Disc.	Lloji i Dokumentit	Numri i Serisë
Titulli i Projektit:	Gazsjellësi Trans Adriatik – TAP					AAL00-ERM-641-Y-TAE-1007 Rish.: 03
Titulli i Dokumentit:	VNMS Shqipëri					
	SEKSIONI 5 – Stili dhe metodologjia e VNMS					

5.3 Studimi për vlerësimin e gjendjes (*Scoping*)

5.3.1 Konsideratat e Përgjithshme

Sipas udhëzimit të BE-së për studimin *Scoping*¹, një nga qëllimet kyçe në një stad të hershëm të VNMS është identifikimi i pasojave të mundshme madhore të Projektit që do të kërkojnë hetim dhe si rezultat i tij, të hartohen termat e referencës për studimet e vlerësimit.

Prandaj si një hap fillestar të procesit të VNMS-së, TAP AG ka ndërmarrë studim *scoping* të projektit për të përcaktuar çështjet kyçe për projektin dhe për të përcaktuar qëllimin e plotë të VNMS-së.

Raporti i studimit *Scoping* i VNMS –së në Shqipëri (TAP-FEED-AL EIA-REP-7028) u përgatit nga TAP AG në Prill 2011. Ai përshkroi procesin e hulumtimit për alternativa të gjurmës dhe të përzgjedhjes së gjurmës, përbërësit kryesorë dhe karakteristikat e spikatura të projektit, çështjet e mundshme mjedisore dhe sociale të përfshira në zbatimin e projektit, zbutjen e mundshme, dhe programin e propozuar të studimit të VNMS-së përfshirë hapat e konsultimit të mëtejshëm të parashikuar. Ky Raport iu parashtrua Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU) si një masë vullnetare e praktikës më të mirë (studimi *Scoping* si i tillë nuk është i parashikuar si një hap procedural në rregulloren shqiptare të VNM-së) dhe u publikua më pas në faqen e internetit të TAP-it.² Për shkak të mungesës së kërkesave rregulatore në atë kohë, TAP-i AG nuk mori informatë kthyes formale mbi Raportin e studimit *Scoping*.

5.3.2 Vlerësimi Teknik

Projekti përkufizohet që përfshin të gjitha ato veprime dhe veprimtari që janë pjesë e nevojshme e zhvillimit përfshirë të gjitha objektet dhe pajisjet e lidhura me të dhe ato ndihmëse pa të cilat Projekti nuk mund të vazhdojë më tej.

Përkufizimi i Projektit përjashton veprimtaritë që nxiten që të ndodhin nga Projekti, por të cilat nuk janë thelbësore për zhvillimin e tij dhe ndërmerren nga të tjerë. Gjithsesi, ndikimet e këtyre veprimtarive do të merren gjithashtu parasysh në vlerësim në kuadrin e ndikimeve kumulative (shiko *Seksionin 5.7.6*)

5.3.3 Vlerësimi Hapësinor

VNMS-ja përcakton qartë atë të cilës i referohemi në mënyra të ndryshme si “vlerësimi hapësinor”, “zona e studimit” ose “zona e ndikimit” për Projektin dhe VNMS-në e tij. BERZH-i përcakton në mënyrë zonat e ndikimit në termat e mëposhtme të cilat riprodhohen më poshtë me komentet mbi zbatimin e tyre në VNMS-në e Projektit TAP. Sa vijon është përdorur një udhëzuesi për të përcaktuar elementet që janë subjekt studimi në këtë VNMS.

¹ <http://ec.europa.eu/environment/eia/eia-guidelines/g-scoping-full-text.pdf>

² http://www.trans-adriatic-pipeline.com/fileadmin/pdfs/TAP-FEED-AL-EIA-REP-7028_ESIA_Scoping_Rep_Albania.pdf

 	Faqja 6 nga 22					
	Kodi Zonal	Kodi i Kompjut erit	Kodi i Sistemit	Kodi i Disc.	Lloji i Doku mentit	Numri i Serisë
Titulli i Projektit:	Gazsjellësi Trans Adriatik – TAP					AAL00-ERM-641-Y-TAE-1007 Rish.: 03
Titulli i Dokumentit:	VNMS Shqipëri					
	SEKSIONI 5 – Stili dhe metodologjia e VNMS					

Kuadrati 5.3-1 Përkufizimet e BERZH për Zonat e Ndikimit

- (i) “Asetet dhe objekte në pronësi të drejtpërdrejtë ose të menaxhuara nga klienti, që lidhen me aktivitetet e projektit që do të financohet (si impianti i prodhimit, korridoret e transmetimit të energjisë, gazsjellësit, kanalet, portet, rrugët e aksesit dhe kampet e ndërtimit).” Këto do të vlerësohen automatikisht në VNMS.
- (ii) “Aktivitetet mbështetëse/mundësuese, asetet dhe objektet ndihmese në pronësi ose nën kontrollin e palëve të kontraktuara për funksionimin e biznesit të klientëve ose për zbatimin e projektit (si kontraktorët).” Në këtë stad të zhvillimit të projektit çështje të tilla mbeten për t’u zgjidhur. Gjithsesi PAMS do të përcaktojë qartë masat menaxhuese që TAP AG do të marrë parasysh në lidhje me çështje të tilla si menaxhimi i kontraktorëve dhe prokurimi i produkteve dhe shërbimeve.
- (iii) “Objektet ndihmese ose bizneset e lidhura me të që nuk financohen nga BERZH-i si pjesë e projektit dhe mund të jenë entitete ligjore të veçanta, por që jeta dhe ekzistenca e të cilave varet gjithsesi vetëm nga projekti dhe produktet dhe shërbimet e të cilave janë thelbësore për funksionimin e suksesshëm të projektit.” Pozicioni në këtë stad është që secili objekt apo pajisje që është thelbësor për funksionimin e suksesshëm të Projektit është pjesë e Projektit dhe prandaj do të jetë subjekt ndaj kërkesave të huadhënësit. Prandaj në këtë stad këto çështje nuk besohet se lidhen me Projektin.
- (iv) “Objektet ndihmese, operacionet, dhe shërbimet në pronësi të klientit ose të menaxhuara nga ai, të cilat janë pjesë e paketës së sigurisë që i janë parashtruar BERZH-it si kolateral”. Çështje të tilla mbeten për t’u përcaktuar por nuk parashikohen të kenë ndikim mbi qëllimin hapësinor të VNMS-së.
- (v) “Zonat dhe komunitetet që mund të ndikohen nga: pasojat e akumuluar nga zhvillimi i mëtejshëm i planifikuar i projektit ose nga burime të tjera ndikimesh të ngjashme në zonën gjeografike, çdo projekt ose gjendje ekzistuese, dhe çdo zhvillim tjetër i lidhur me projektin që mund të pritet me të vërtetë në kohën kur ndërmerret *due diligence*.” Këto do të vlerësohen automatikisht në VNMS.
- (vi) “Zonat dhe komunitetet që mund të preken nga ndikimet nga zhvillimet e paplanifikuara por të parashikueshme të shkaktuara nga projekti që mund të ndodhin më vonë ose në një vend tjetër. Zona e ndikimit nuk përfshin ndikimet e mundshme që do të ndodhnin pa projektin ose në mënyrë të pavarur nga projekti”. Këto do të vlerësohen automatikisht në VNMS.

Përpunuar nga ERM (2012)

Vlerësimi hapësinor ndryshon në varësi të llojit të ndikimit që merret në konsideratë dhe në disa raste është ndryshuar ndërkohë që vlerësimi përparonte. Në secilin rast ai përfshin të gjitha zonat brenda të cilave ka gjasa për pasoja të konsiderueshme dhe merr parasysh konsideratat e mëposhtme:

- shkallën fizike të punëve të propozuara, të përcaktuara nga kufijtë e tokës që do të blihet ose përdoret (përkohësisht ose përgjithmonë) nga Projekti.
- natyrën e mjedisit fillestar dhe mënyrën në të cilën ndikimet kanë gjasa të përhapen përtej kufijve të Projektit.

Zona e ndikimit mund të shtrihet gjithashtu përtej kufijve administrativë ose kombëtarë dhe prandaj vlerësimi i ka marrë në konsideratë këto efekte ndërkufitare.

5.3.4 Vlerësimi Kohor

Ndikimet janë identifikuar dhe vlerësuar për të gjitha fazat e zhvillimit të Projektit nga përgatitja fillestare e vendit, përfshirë të gjitha punët paraprake, përmes ndërtimit, aktivizimit dhe funksionimit, deri te çaktivizimi, restaurimi dhe pas përdorimi (në shkallën që këto tre të fundit mund të kuptohen në këtë kohë).

 	Faqja 7 nga 22					
	Kodi Zonal	Kodi i Kompjuterit	Kodi i Sistemit	Kodi i Disc.	Lloji i Dokumentit	Numri i Serisë
Titulli i Projektit: Gazsjellësi Trans Adriatik – TAP Titulli i Dokumentit: VNMS Shqipëri SEKSIONI 5 – Stili dhe metodologjia e VNMS	AAL00-ERM-641-Y-TAE-1007 Rish.: 03					

Meqenëse kohëzgjatja e planifikuar e Projektit konsiderohet të jetë 50 vjet¹, vlerësimi merr gjithashtu në konsideratë zhvillimin autonom të aspekteve përkatëse të studimit bazë përgjatë kësaj kohe dhe vlerëson nivelin në të cilin ndikimet influencohen nga ndryshimet e projektuara dhe prirjet.

5.4 Raporti i VNMS

Nën-seksionet e mëposhtme paraqesin Termat e Referencës kyçe të këtij Raporti të VNMS-së: Objektivat e VNMS-së; Hapat e VNMS-së; dhe përkufizimi i Fushës së Projektit dhe Fushave të Ndikimit.

5.4.1 Objektivat

Synimi i VNMS-së është:

- Të identifikojë kornizën ligjore të aplikueshme për projektin;
- Të përshkruajë karakteristikat kryesore të projektit dhe specifikimet teknike;
- Të përmbledhë përfaqsimin e përdorur nga TAP-i AG për projektimin e gazsjellësit dhe vlerësimin e alternativave për projektin;
- Të përshkruajë gjendjen bazë sociale dhe mjedisore të projektit lidhur me ndjeshmëritë kyçe dhe kufizuesit e mundshëm ndaj ndërtimit, funksionimit dhe mirëmbajtjes së gazsjellësit;
- Të vlerësojë ndikimet e mundshme negative dhe pozitive dhe rreziqet e mundshme të projektit dhe të aktiviteteve të lidhura me projektin mbi mjedisin (përfshirë burimet biofizike dhe socio-ekonomike); dhe
- Të hartojë masat për zbutjen e pasojave ose përmirësimin e tyre për të ruajtur ndikimet pozitive dhe për të shmangur, larguar ose pakësuar ndikimet negative dhe rreziqet për mjedisin.

¹ Fasilitetet TAP (stacionet e kompresorit, pajisjet) do të projektohen me një jetëgjatësi 25 vjeçare, ndërsa vetë gazsjellësi është i projektuar me një jetëgjatësi 50 vjeçare. Pas 25 vjetësh pajisjet e stacionit do të zëvendësohen. Duhet theksuar gjithsesi, që sistemi i gazsjellësit me mirëmbajtje të mirë mund të ketë një jetëgjatësi teknike konkrete që mund të jetë shumë më e gjatë se sa jetëgjatësia formale e projektuar.

 	Faqa 8 nga 22					
	Kodi Zonal	Kodi i Kompjuterit	Kodi i Sistemit	Kodi i Disc.	Lloji i Dokumentit	Numri i Serisë
Titulli i Projektit: Gazsjellësi Trans Adriatik – TAP Titulli i Dokumentit: VNMS Shqipëri SEKSIONI 5 – Stili dhe metodologjia e VNMS	AAL00-ERM-641-Y-TAE-1007 Rish.: 03					

5.4.2 Fazat dhe Hapat e VNMS

Fazat dhe hapat kyçe në procesin e VNMS-së janë përshkruar më poshtë.

Faza I, Përzgjedhja dhe Ndryshimi i Gjurmës (shiko *Seksionin 2* për detaje): përzgjedhja dhe ndryshimi fillestar i gjurmës u krye përpara fillimit të VNMS-së. Gjithsesi, faza e ndryshimit të gjurmës ka vazhduar paralelisht me studimin e VNMS-së, duke marrë parasysh të dhënat kyçe mjedisore, sociale dhe kulturore të identifikuar. Në këmbim, procesi i ndryshimit të gjurmës ka plotësuar me të dhëna procesin e VNMS-së, kështu që Raporti i VNMS-së është përditësuar në bazë të gjurmës së ndryshuar. Prandaj, kjo fazë është një fazë përfshirëse që ka shoqëruar hapat vijuese të mëposhtme të VNMS-së.


Faza II: Studimi VNMS

- **Aktivitetet para-studimit** si incizimi i gjendjes, vlerësimi paraprak dhe studimi *scoping*. Kjo fazë përcakton konsideratat mjedisore, sociale dhe kulturore përpara studimeve të detajuara.
- **Studimi VNMS**, i cili çon në identifikimin dhe vlerësimin e pasojave. Domosdoshmëri për këtë studim është hartimi i masave për zbutjen dhe pakësimin ose largimin e pasojave të pafavorshme dhe ruajtjen ose shtimin e atyre pozitive.
- **Stadi pas-studimit**, i cili përfshin hapat e ndërmarrë për rishikim dhe monitorim për të siguruar që masat zbutëse të zbatohen, dhe që ato janë efektive gjatë ndërtimit dhe funksionimit.

Për ta përmbledhur, VNMS-ja ndjek një proces sistematik dhe përsëritës të ekzaminimit të kontekstit mjedisor, socio-ekonomik dhe rregullator brenda të cilit vendoset projekti. *Figura 5.4-1* paraqet grafikisht procesin e VNMS-së.

 	Faqja 9 nga 22					
	Kodi Zonal	Kodi i Kompjuterit	Kodi i Sistemit	Kodi i Disc.	Lloji i Dokumentit	Numri i Serisë
Titulli i Projektit: Gazsjellësi Trans Adriatik – TAP						AAL00-ERM-641-Y-TAE-1007 Rish.: 03
Titulli i Dokumentit: VNMS Shqipëri						
SEKSIONI 5 – Stili dhe metodologjia e VNMS						

Figura 5.4-1 Skema e Procesit të VNM



ERM (2012)

5.4.2.1 Gjurma e Projektit

Ashtu siç përshkruhet në *Seksionin 2*, gjurma e TAP-it në Shqipëri është përzgjedhur pas një procesi të gjatë dhe tërësor të vlerësimit të gjurmëve alternative, kryer nga TAP-i me qëllim përzgjedhjen e një gjurme gazsjellësi të realizueshme nga ana teknike dhe me pasoja sa më të pakta mjedisore, socio-ekonomike dhe mbi trashëgiminë kulturore.

Në përzgjedhjen e gjurmës së preferuar (ose “*rasti bazë*”) u fillua një proces i ndryshimit të gjurmës u fillua me qëllim optimizmin e rrugës, veçanërisht përgjatë atyre seksioneve të cilat paraqesin sfida më të mëdha teknike, mjedisore, socio-ekonomike dhe të trashëgimisë kulturore. Procesi i rafinimit të gjurmës nga ai fillestar, *rastit bazë*, në shkallë *makro* dhe *meso* mund të konsiderohet i përfunduar në momentin e shkrimit të këtij raporti. Si pasojë e këtij procesi, të përshkruar në detaje në *Seksionin 2*, janë shmangur një numër i madh ndikimesh të konsiderueshme mjedisore, sociale dhe kulturore.

 	Faqa 10 nga 22					
	Kodi Zonal	Kodi i Kompjut erit	Kodi i Sistemit	Kodi i Disc.	Lloji i Doku mentit	Numri i Serisë
Titulli i Projektit: Titulli i Dokumentit:	Gazsjellësi Trans Adriatik – TAP VNMS Shqipëri SEKSIONI 5 – Stili dhe metodologjia e VNMS					AAL00-ERM-641-Y-TAE-1007 Rish.: 03

Zona e projektit TAP AG përfshin zonën e ndikimit të të gjitha aktiviteteve të projektit, ku do të kryhet punë drejtpërsëdrejti. Kjo përfshin brezin e punës, rrugët e aksesit, stacionet e kompresorit, stacionet e valvolave të bllokimit dhe zonat e përkohshëm të depozitimit dhe kampet e punëtorëve (shih *Seksionin 4*).

5.4.2.2 Zona e Ndikimit e Projektit

Për qëllimin e kësaj VNMS-je, zona e ndikimit për aktivitetet e Projektit TAP është përcaktuar si zona në të cilën mund të ndodhë një ndikim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë mbi mjedisin fizik, biologjik, social ose kulturor (krahaso me Kuadrati 5.3-1 më lart). Për analizën e detajuar të gjendjes bazë aktuale të projektit, janë përcaktuar zonat e mëposhtme të ndikimit.

Mjedisi Tokësor:

- Për ndikimet mjedisore, zona e ndikimit përcaktohet si një korridor 500 m i gjatë përgjatë vijës qendrore të propozuar të gazsjellësit (250 m i gjerë në secilën anë) dhe 500 m larg vijës kufitare të kampeve të punëtorëve të propozuara, SBV, fushave të tubacioneve dhe stacioneve të kompresorëve. Kjo zonë konsiderohet e mjaftueshme për të përfshirë zonën e prekur fizikisht nga aktivitetet e projektit dhe shumica e ndikimeve mjedisore përtej kantierit (p.sh. ndikimet e zhurmës dhe të cilësisë së ajrit).
- Për ndikimet socio-ekonomike, zona e drejtpërdrejtë e ndikimit përcaktohet si një korridor 2 km i gjatë përgjatë vijës qendrore të gazsjellësit të propozuar (1 km i gjerë në secilën anë) dhe 1 km larg vijës kufitare të kampeve të punëtorëve, SBV, fushave të tubacioneve dhe stacioneve të kompresorëve të propozuar. Vendbanimet brenda kësaj zone do të preken më së shumti nga zonat e ndikimeve të drejtpërdrejta si përdorimi i tokës, ndërprerja e infrastrukturës dhe ulja e cilësisë mjedisore.
- Për ndikimet mbi trashëgiminë kulturore, zona e ndikimit përcaktohet si një korridor 50 m përgjatë vijës qendrore të gazsjellësit të propozuar që të përfshijë ndikimet e shqetësimeve fizike të shkaktuara përgjatë trasesë së punës. Zona e ndikimit për kampet e punëtorëve, SBV, fushat e tubacioneve dhe stacionet e kompresorëve do të përvijohen në mënyrë të ngjashme nga gjurma fizike e tyre.
- Zona ndikimi specifike për receptorë të ndryshëm: Zona specifike e drejtpërdrejtë e ndikimit për disa receptorë është në disa raste më e gjerë se sa 2 korridoret e përshkruara më sipër. Për këto raste, janë përcaktuar zona ndikimi specifike në seksionet e tyre përkatëse të kapitullit bazë. Shembuj të këtyre përfshijnë:
 - Zonat e shkarkimit të lumenjve të prekur drejtpërsëdrejti nga aktivitetet e projektit, ose të lumenjve të tjerë që kalojnë në afërsi të zonës së projektit për të cilët ndikimet e tërthorta nga projekti konsiderohen si të mundshme;
 - Speciet e lëvizshme që mund të udhëtojnë përmes kantierit (në migrim) ose që mund të jenë të lidhura me një zonë të mbrojtur dhe përdorin vendbanim tjetër në zonën

 	Faqja 11 nga 22					
	Kodi Zonal	Kodi i Kompjuterit	Kodi i Sistemit	Kodi i Disc.	Lloji i Dokumentit	Numri i Serisë
Titulli i Projektit: Titulli i Dokumentit:	Gazsjellësi Trans Adriatik – TAP VNMS Shqipëri SEKSIONI 5 – Stili dhe metodologjia e VNMS					AAL00-ERM-641-Y-TAE-1007 Rish.: 03

më të gjerë (siç ndodh shpesh me specie zogjsh dhe grykëderdhjet e lumenjve) dhe prandaj mund të preken drejtpërsëdrejti ose tërthorazi nga aktivitetet e projektit;

- Zonat kryesore të populluara jashtë korridorit 2 km të gjatë mund të preken drejtpërsëdrejti dhe tërthorazi nga aktivitetet e projektit (p.sh., rrjeti i furnizimeve, infrastruktura dhe sistemi i transportit, baza e punësimit, shërbimet, etj.)

Mjedisi detar:

- Për ndikimet mjedisore, zona e ndikimit përcaktohet si:
 - Për zonën afër bregut, niveli maksimal i sedimentit lymor të lidhur me të sipas rezultateve të modelimit të sedimenteve. Kjo bazohet në një sediment lymor në një nivel maksimal prej 7300 m në Veri të aktiviteteve gjurmuese dhe një nivel i mbetur 200 m në jug. Aktivitetet afër bregut përfshijnë gjurmim që do të krijojë një transhe prej afro 2 km të gjatë nga bregu deri tek Kp 2 me gjerësi maksimale prej 160 m dhe thellësi maksimale prej 7 m. Kjo zonë konsiderohet e mjaftueshme për të rrethuar zonën e prekur fizikisht nga aktivitetet e projektit dhe shumicën e ndikimeve mjedisore jashtë kantierit (p.sh. zhurma dhe ndikimet në cilësinë e ajrit). Pas Kp 2 gjurmimi do të jetë mjaft më i vogël me gjerësi maksimale 2 m dhe thellësi 0.5 m.
 - Për zonën detare gjatë ndërtimit, zona ku do të paraqiten pasoja do të jetë një rreth i lëvizshëm (sipas një ritmi prej 2-3 km tubacion të shtrirë çdo ditë) përreth platformës shtrirëse (anije për shtrimin e tubacioneve) me rreze rreth 2-3 km (në varësi të përdorimit dhe llojit të spirancës).
- Për ndikimet socio-ekonomike, zona e drejtpërdrejtë e ndikimit përcaktohet si
 - Për zonën afër bregut gjatë ndërtimit, një korridor afërsisht 2 km i gjerë përgjatë vijës qendrore të gazsjellësit të propozuar (1 km i gjerë në secilën anë), sipas kufizimit të lundrimit.
 - Për zonën detare gjatë ndërtimit, një rreth që lëviz përreth platformës shtrirëse (zonës së sigurisë) me rreze rreth 2-3 km (në varësi të lëshimit të spirancës) do të adoptohet për të shmangur incidentet me trafikun detar.
- Për ndikimet mbi trashëgiminë kulturore, zona e ndikimit përcaktohet si
 - Për zonën afër bregut, një korridor 350 m i gjerë përgjatë vijës qendrore të gazsjellësit të propozuar për të akomoduar ndikimet e shqetësimeve fizike të krijuara nga hendeku 160 m dhe dheu i përkohshëm nga gjurmimet paralel me korridorin.
 - Për zonën detare, zona fqinje me gazsjellësin.

 	Faqja 12 nga 22					
	Kodi Zonal	Kodi i Kompjuterit	Kodi i Sistemit	Kodi i Disc.	Lloji i Dokumentit	Numri i Serisë
Titulli i Projektit: Gazsjellësi Trans Adriatik – TAP	AAL00-ERM-641-Y-TAE-1007					
Titulli i Dokumentit: VNMS Shqipëri	Rish.: 03					
SEKSIONI 5 – Stili dhe metodologjia e VNMS						

5.5 Metodologjia Bazë e Studimit

Për ofrimin e bazës mjedisore për gjurmën e TAP-it në Shqipëri, u përdorën metoda specifike të tematikave të ndryshme. Ky seksion paraqet një përmbledhje të metodologjive të përdorura për secilën nga disiplinat mjedisore, sociale dhe kulturore si dhe paraqet kriteret në bazë të të cilave mund të vlerësohen kushtet bazë dhe rëndësia e karakteristikave dhe ndjeshmërive të tyre. Kufizimet janë shpjeguar aty ku është e përshtatshme. Detaje të metodave për analiza specifike (p.sh. mostrat e ujit) mund të gjenden në *Shtojcën teknike 5.1* dhe *Shtojcën 6 Të Dhënat bazë*. Për më tepër, në *Shtojcën 4* jepet gjithashtu harta që paraqet pikat e marrjes së mostrave dhe zonën e studimit.

Kuptimi i mirë i gjendjes bazë është çelësi për të kuptuar natyrën dhe rëndësinë e ndikimeve të projektit dhe në dhënien e informatave kthyesë (feedback) ndaj hartimit të projektimit dhe në përcaktimin e gjurmës. U mbledhën të dhënat që përshkruhen në detaje në *Seksionin 6*.

Informacioni bazë u mbledh gjatë staveve të ndryshme të hartimit të gjurmës dhe në veçanti për gjurmën përfundimtare të zgjedhur (gjurma e *rastit bazë* mbi të cilën bazohet kjo VNMS).

5.5.1 GIS, Hedhja në Hartë dhe Treguesit

Informacioni i grumbulluar gjatë studimit në terren, së bashku me harta pamore satelitore me rezolucion të lartë dhe tematikë përkatëse, u integrua për të krijuar një mjet ndërveprues duke përdorur një Sistem Informacioni Gjeografik (GIS). Ky mjet lejon integrimin e të dhënave të disiplinave të ndryshme dhe krijimin e hartave dhe të figurave që tregojnë kombinime të ndryshme të të dhënave përkatëse. U krijua një bazë të dhënash GIS për secilin vend me interes, në mënyrë që të mund të nxirrej informacion mbi rëndësinë e vendit dhe të mund të lidheshin fotografitë që kishin të bënin me to.

Përdorimi i GIS-it ishte i rëndësishëm për interpretimin e të dhënave të grumbulluara dhe për analizimin dhe paraqitjen e informacionit përkatës në hartat dhe grafikët e zonës së studimit.

5.5.2 Metodologjitë Tematike Specifike

Për hartimin e të dhënave bazë për disiplina të ndryshme janë përdorur metodologji specifike. Informacioni i detajuar mbi metodologjitë e përdorura për të përfutur të dhëna mjedisore, sociale dhe kulturore paraqitet në *Shtojcën 5*.

5.6 Konsideratat e VNMS në Planifikimin dhe Hartimin e Projektit

Deri më sot, TAP AG, për të siguruar përkufizimin e Projektit ka ndërmarrë një sasi të konsiderueshme pune hartuese, përfshirë vlerësimin e alternativave.

 	Faqja 13 nga 22					
	Kodi Zonal	Kodi i Kompjuterit	Kodi i Sistemit	Kodi i Disc.	Lloji i Dokumentit	Numri i Serisë
Titulli i Projektit:	Gazsjellësi Trans Adriatik – TAP					AAL00-ERM-641-Y-TAE-1007 Rish.: 03
Titulli i Dokumentit:	VNMS Shqipëri					
	SEKSIONI 5 – Stili dhe metodologjia e VNMS					

Hartimi i VNMS-së kërkonte koordinim dhe ndërveprim midis ekipit të VNMS-së dhe ekipeve hartuese të Projektit mbi çështjet që përfshijnë:

- Vlerësimi i teknologjive alternative dhe i metodave të punës, për shembull i teknikave të ndryshme për kalimin e rrymave ujore, për të treguar zbatimin e hierarkisë zbutëse në mënyrë që pasojat ose të shmangen, ose pasojat e mbetura të mënjanohen sa më shumë të jetë e zbatueshme logjikisht dhe/ose në një nivel që mund të mendohet i pranueshëm.
- Identifikimi i masave zbutëse trashmë të integruara në dizajn.
- Llogaritja e punësimit, përdorimit të burimeve, tokës së marrë, emetimeve, shkarkimeve dhe mbetjeve për t'i përfshirë në parashikimin e ndikimeve.
- Ballafaqimi me studimet për sigurinë për të kuptuar dhe vlerësuar rreziqet madhore të mundshme që mund të çojnë në pasoja të mundshme ndaj sigurisë së mjedisit ose të komunitetit.
- Marrja e mëtejshme në konsideratë e përjasjeve alternative për të balancuar dhe kompensuar pasojat.
- Hartimi dhe rënia dakord mbi masat e mëtejshme zbutëse gjatë fazës së funksionimit.

Ndërveprimi midis ekipit të VNMS-së dhe atij hartues dhe vendim-marrësve të TAP AG përfshiu gjithashtu workshop-e të fokusuara rreth zbutjes që supozohej se do të përfshihej në hartim dhe në praktikën e ndërtimit të mirë, nevojës për zbutje shtesë dhe mundësive për adresimin e disa prej çështjeve kyçe për Projektin.

Ndonëse ky Raport i VNMS-së paraqet informacion gjithëpërfshirës mbi aktivitetet e planifikuara që do të ndërmerren gjatë ndërtimit dhe funksionimit të TAP, VNMS-ja si proces do të vazhdojë të ndikojë në menaxhimin e hartimit, zbatimit, autorizimit dhe funksionimit të projektit. Një element kyç në arritjen e detyrimeve menaxhuese mjedisore dhe sociale të Projektit do të jetë ndërveprimi i vazhdueshëm midis inxhinierëve të hartimit, ndërtimit, autorizimit dhe funksionimit, kontraktorëve dhe specialistëve mjedisorë dhe socialë. Shtytës kryesor për menaxhimin e këtij ndërveprimi është përcjellja e planeve, masave dhe udhëzimeve menaxhuese që do të përmbahen në Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social të Projektit (PVMSP). PVMSP-i do të shtohet dhe përmirësohet nga konsultimi i vazhdueshëm me palët e interesuara, studimet mjedisore dhe sociale dhe rishikimi i projektit.

 	Faqja 14 nga 22					
	Kodi Zonal	Kodi i Kompjuterit	Kodi i Sistemit	Kodi i Disc.	Lloji i Dokumentit	Numri i Serisë
Titulli i Projektit: Gazsjellësi Trans Adriatik – TAP Titulli i Dokumentit: VNMS Shqipëri SEKSIONI 5 – Stili dhe metodologjia e VNMS	AAL00-ERM-641-Y-TAE-1007 Rish.: 03					

5.7 Metodologjia e Vlerësimit të Ndikimeve

5.7.1 Konsiderata të Përgjithshme

Vlerësimi i ndikimeve është një proces ndërveprues që merr në konsideratë katër pyetje:

- Parashikimi – çfarë do t'u ndodhë mjedisit dhe njerëzve si rezultat i ndikimeve dhe rreziqeve të mundshme të lidhura me Projektin TAP?
- Vlerësimi – a ka rëndësi ky ndikim? Sa i rëndësishëm apo i konsiderueshëm është ai?
- Zbutja e pasojave – nëse janë të konsiderueshme, a mund të bëjmë ndonjë gjë?
- Ndikimi/rreziku i mbetur – a është akoma i konsiderueshëm?

Aty ku mbeten pasoja ose rreziqet të konsiderueshme, mund të merren në konsideratë mundësi të tjera për zbutje e tyre dhe mund të rivlerësohen derisa të jenë aq të ulëta sa të jenë teknikisht dhe financiarisht të zbatueshme për Projektin si dhe duhet të mendohet që të jenë brenda niveleve të pranueshme.

Seksionet e mëposhtme përshkruajnë disa nga parimet e përgjithshme që mbështesin përjasjen e vlerësimit. *Shtojca 5* përmban informacion mbi metodologjitë, dhe më specifikisht mbi kriteret e rëndësishme (dhe prejardhjen e tyre) të zbatuara për zonat tematike të mëposhtme në Raportin e VNMS-së:

- Mjedisi Fizik;
 - Cilësia e Ajrit
 - Zhurma
 - Burimet Ujore (Ujërat e Ëmbla– Sipërfaqësore dhe Nëntokësore, Detare)
 - Gjeologjia, Gjeomorfologjia, Cilësia e Dheut dhe e Shtratit Detar
 - Peizazhi dhe Kënaqësia Pamore
- Mjedisi Biologjik;
 - Ekologjia - Habitatet
 - Ekologjia - Speciet
- Mjedisi Social;
- Trashëgimia Kulturore.

 	Faqja 15 nga 22					
	Kodi Zonal	Kodi i Kompjuterit	Kodi i Sistemit	Kodi i Disc.	Lloji i Dokumentit	Numri i Serisë
Titulli i Projektit:	Gazsjellësi Trans Adriatik – TAP					AAL00-ERM-641-Y-TAE-1007 Rish.: 03
Titulli i Dokumentit:	VNMS Shqipëri					
	SEKSIONI 5 – Stili dhe metodologjia e VNMS					

5.7.2 Parashikimi i Pasojave

VNMS-ja përshkruan atë që pritet të ndodhë duke parashikuar magnitudën e ndikimeve (dhe duke i llogaritur këto në nivelin e zbatueshëm, i cili ndryshon në varësi të temave që po vlerësohen). Termi “magnitudë” përdoret si stenografi për të përfshirë të gjitha dimensionet e ndikimit të parashikuar përfshirë:

- Natyrën e ndryshimit (çfarë preket dhe si preket);
- Përmasat, shkallën ose intensitetin dhe drejtimin e tij (*d.m.th.* nëse është e pafavorshme apo e dobishme);
- Shkallën dhe shpërndarjen gjeografike të tij;
- Kohëzgjatjen, shpeshtësinë dhe kthyeshmërinë e tij;¹
- Aty ku është e përshtatshme, mundësinë e rreziqeve që ndodhin si pasojë e ngjarjeve aksidentale ose të paplanifikuara.

Vlerësimi i magnitudës së pasojave ndaj receptorëve njerëzorë, për shembull një shtëpie, komuniteti ose një grupi social më të gjerë, merr parasysh përgjigjen e tyre të mundshme ndaj ndryshimit dhe mundësinë e tyre për t’iu përshtatur dhe për të menaxhuar efektet e ndikimit.

Parashikimi merr parasysh masat zbutëse që janë tashmë një pjesë integrale e hartimit. Parashikimi merr gjithashtu në konsideratë çdo pasiguri rreth ndodhjes ose shkallës së ndikimit, të shprehur si intervale, kufij sigurie ose mundësi (këtu bëhet një dallim midis (i) mundësisë së rreziqeve që vijnë nga një ngjarje jo-rutinë si rrjedhja dhe shpërthimi pasues i mundshëm, dhe (ii) mundësisë së një ndikimi të pasigurt; për shembull mund të mos jetë e sigurt që speciet migruese do të jenë të pranishme gjatë ndërtimit; që shëndeti do të preket nga emetimet në atmosferë apo që njerëzit lokalë do të punësohen nga Projekti).

Është paraqitur një vlerësim i përgjithshëm i magnitudës së ndikimeve duke marrë parasysh të gjitha ndryshoret e rëndësishme të përmendura më lart për të përcaktuar nëse një ndikim është i një magnitude të neglizhueshme, të vogël, mesatare ose të madhe. Kjo shkallë përcaktohet në mënyra të ndryshme në varësi të llojit të ndikimit. Për ndikimet lehtësisht të kuantifikueshme, si zhurma, përdoren vlera numerike ndërsa për temat e tjera (p.sh. ekologjia) nevojitet një vlerësim më cilësor. Rreziqet mjedisore dhe sociale gjatë punëve ndërtimore (p.sh. ndotja e dheut dhe ujit nga derdhjeve aksidentale ose mosmarrëveshjet sociale midis popullatës lokale dhe punonjësve të ndërtimit) si dhe rreziqet e lidhura me ngjarjet jo të zakonshme gjatë operimeve adresohen në

¹ Përkufizimet për këto karakteristika të ndryshimeve luhaten në çdo përbërës mjedisor/social dhe përshkruhen më në detaje në Shtojcën 5, aty ku gjejnë zbatim. Karakteristikat e ndikimeve duhet të diskutohen në kontekstin e tyre. Një shembull për të ilustruar “kthyeshmërinë” është humbja e habitatit. Humbja e bimësisë së kullotave nga krijimi i rripit të ndërtimit është mjaft e kthyeshme nëpërmjet rivendosjes së habitatit të përshtatshëm sapo gazsjellësi të jetë shtrirë, ndërsa humbja e habitatit me pyje të vjetra nuk është e kthyeshme, sepse (i) brezi i mbrojtjes së gazsjellësit 8 m i gjerë (BMG) nuk lejon rimbjelljen e pemëve, dhe (ii) aty ku pemët mund të rimbillen jashtë BMG-së, do t’u duhen dekada për tu rritur.

 	Faqja 16 nga 22					
	Kodi Zonal	Kodi i Kompjuterit	Kodi i Sistemit	Kodi i Disc.	Lloji i Dokumentit	Numri i Serisë
Titulli i Projektit:	Gazsjellësi Trans Adriatik – TAP					AAL00-ERM-641-Y-TAE-1007 Rish.: 03
Titulli i Dokumentit:	VNMS Shqipëri					
	SEKSIONI 5 – Stili dhe metodologjia e VNMS					

mënyrë cilësore (edhe pse gjatë kësaj faze të Projektit ishin në dispozicion vlerësimet përkatëse sasiore të rreziqeve). Nëse ndikimet janë detajuar përmes mjeteve sasiore apo cilësore në përcaktimin e ndikimeve apo mbetje të rreziqeve, janë marr në konsideratë masat për zbutjen e tyre. Detajet se si është parashikuar magnituda e ndikimeve dhe rreziqeve paraqiten në *Shtojcën 5*.

5.7.3 Vlerësimi i Rëndësisë

Hapi i radhës në vlerësim ishte marrja e informacionit mbi magnitudën e ndikimeve, dhe shpjegimi se çfarë do të thotë kjo lidhur me rëndësinë e saj për shoqërinë natyrore, sociale dhe kulturore dhe mjedisin, në mënyrë që vendimmarrësit dhe palët e interesuara të kuptojnë sa peshë duhet t'i jepet një çështjeje të caktuar në përcaktimin e këndvështrimit të tyre për Projektin. Këtij hapi i referohemi si “vlerësimi i rëndësisë”.

Nuk ka ndonjë përkufizim të rëndësisë (në kontekstin e VNMS-së) për të cilën të jetë rënë dakord; gjithsesi, për qëllimet e këtij VNMS-je, përdoret përkufizimi praktik i mëposhtëm:

Një ndikim është i rëndësishëm nëse, i vetëm ose i kombinuar me ndikimet e tjera, ai, sipas gjykimit të ekipit të VNMS-së, duhet raportuar në raportin e VNMS-së në mënyrë që të merret parasysh në marrjen e vendimeve mbi Projektin.

Kjo pranon që vlerësimi ka nevojë për një ushtrim gjykimi dhe se gjykimet mund të luhaten midis palëve të përfshira në proces. Vlerësimi i ndikimeve të paraqitura në Raportin e VNMS-së bazohet në gjykimin e ekipit të VNMS-së, i informuar duke iu referuar standardeve ligjore, politikave qeveritare kombëtare dhe rajonale, kërkesave të huadhënësve, praktikës ndërkombëtare të mirë aktuale dhe këndvështrimeve të palëve të interesuara.

Me qëllim maksimizimin e transparencës së VNMS-së, janë përcaktuar kritere për vlerësimin e rëndësisë së ndikimeve për secilën çështje dhe lloj ndikimi. Në mënyrë tipike, këto kritere marrin parasysh nëse Projekti do të:

- Shkaktojë tejkalimin e standardeve mjedisore ligjore ose të rëna dakord, p.sh., cilësia e ajrit, ujit dhe tokës, nivelet e zhurmave, ose do të japë një kontribut të dukshëm në rritjen e gjasave për tejkalimin e tyre.
- Ndikojë në mënyrë të pafavorshme mbi zonat ose tiparet e mbrojtura, ose mbi burimet e çmuara, p.sh. zonat e ruajtjes së natyrës, speciet e rralla ose të mbrojtura, peizazhet e mbrojtura, tiparet historike, tokat bujqësore të cilësisë së lartë, burimet e rëndësishme të furnizimit me ujë, shërbime të tjera ekosistemesh kyçe.
- Hyjë në konflikt me politikat qeveritare të përcaktuara p.sh. pakësimi i emetimeve të CO₂, riciklimi i mbetjeve, rigjenerimi i zonave urbane të dëmtuara, mbrojtja e të drejtave të njeriut.
- Ketë një efekt të dobishëm mbi mjedisin natyror, social ose kulturor p.sh. krijimi i vende të punës në shkallë lokale dhe/ose krijimi i përfitimeve për komunitetin dhe ekonominë lokale.


 	Faqja 17 nga 22					
	Kodi Zonal	Kodi i Kompjuterit	Kodi i Sistemit	Kodi i Disc.	Lloji i Dokumentit	Numri i Serisë
Titulli i Projektit:	Gazsjellësi Trans Adriatik – TAP					AAL00-ERM-641-Y-TAE-1007 Rish.: 03
Titulli i Dokumentit:	VNMS Shqipëri					
	SEKSIONI 5 – Stili dhe metodologjia e VNMS					

Aty ku standardet nuk ishin të disponueshme ose ato si të vetme sigurojnë informacion të pamjaftueshëm për të lejuar shkallëzimin e rëndësisë, rëndësia është vlerësuar duke marrë parasysh magnitudën e ndikimit dhe rëndësinë ose cilësinë (dhe në disa raste, ndjeshmërinë ose prekshmërinë) e burimit ose të receptorit të prekur. Cilësia ose rëndësia e një burimi ose receptorit është gjykuar duke marrë parasysh, për shembull, përcaktimin lokal, rajonal, kombëtar ose ndërkombëtar, rëndësinë e tij për komunitetin lokal ose më të gjerë, funksionin e ekosistemit të tij ose vlerën ekonomike të tij.

Për një shtëpi, komunitet ose grup social më të gjerë, vlerësimi i rëndësisë merr parasysh këndvështrimet e palëve të interesuara siç artikulohe në politikat ose planet ekzistuese ose siç shprehen drejtpërsëdrejti si pasojë e angazhimit të palëve të interesuara që kanë të bëjnë me Projektin.

Magnituda dhe cilësia/rëndësia ose ndjeshmëria janë parë të kombinuara për të vlerësuar nëse një ndikim është i rëndësishëm dhe në rast se po, cila është shkalla e rëndësisë së tij. Parimi ilustron në *Figura 5.7-1*

Figura 5.7-1 Vlerësimi i Rëndësisë



 	Faqa 18 nga 22					
	Kodi Zonal	Kodi i Kompjuterit	Kodi i Sistemit	Kodi i Disc.	Lloji i Dokumentit	Numri i Serisë
Titulli i Projektit:	Gazsjellësi Trans Adriatik – TAP					AAL00-ERM-641-Y-TAE-1007 Rish.: 03
Titulli i Dokumentit:	VNMS Shqipëri					
	SEKSIONI 5 – Stili dhe metodologjia e VNMS					

5.7.4 Zbutja

Vlerësimi i ndikimit është projektuar për të siguruar që vendimet mbi Projektin të merren me njohuri të plota mbi ndikimet e tyre të mundshme mbi mjedisin dhe shoqërinë. Një hap jetësor brenda procesit është identifikimi i masave që do të ndërmerren nga një projekt për të zbutur pasojat e tij.

Në disa raste, zbutja do të jetë pjesë e qenësishme e projektimit dhe në disa të tjera masat zbutëse do të duhet të identifikohen gjatë procesit të VNMS-së. Procesit i vazhdueshëm i VNMS-së ka përfshirë si rrjedhim identifikimin se ku mund të ndodhin ndikime të rëndësishme dhe më pas punën me ekipin e Projektit për të identifikuar dhe hartuar mjete teknikisht dhe financiarisht të realizueshme dhe me kosto-efektive për zbutjen e këtyre ndikimeve në nivele që mendohen të pranueshme. Më pas këto masa është rënë dakord që të jenë në Projekt dhe ato janë integruar në propozimet e Projektit dhe në PAMS si angazhime të qarta.

Aty ku identifikohet një ndikim negativ i rëndësishëm, përgjithësisht u eksplorua një hierarki mundësish zbutjeje si më poshtë:

- **Shmangni që në burim** – largoni burimin e ndikimit.
- **Pakësoni që në burim** – pakësoni burimin e ndikimit.
- **Zbutni** – pakësoni ndikimin midis burimit dhe receptorit.
- **Pakësoni te receptori** – pakësoni ndikimin te receptori.
- **Ndreqni** – rregulloni dëmin pasi të ketë ndodhur.
- **Kompensoni/Zëvendësoni** – zëvendësoni me shërbime ose me një burim tjetër me të njëjtën vlerë.

Kompensimi/zëvendësimi shihet përgjithësisht si shpresa e fundit por mund të jetë i nevojshëm në termat e legjislacionit Lokal (ndonjëherë pavarësisht rëndësisë së një ndikimi). Gjithsesi, kompensimi ose zëvendësimi nuk e bën një ndikim automatikisht “të pranueshëm” apo nuk e justifikon nevojën për të marrë në konsideratë format e tjera të zbutjes të shtjelluara te hierarkia. Kërkesat e performancës së BERZH-it theksojnë nevojën për të eksploruar alternativa për të shmangur ose pakësuar ndikimet.

5.7.5 Vlerësimi i pasojave të mbetura (Reziduale)

Pas marrëveshjes mbi zbutjen teknikisht dhe financiarisht të realizueshme si dhe kosto-efektive, ekspertët e VNMS-së, aty ku ishte e nevojshme, ri-vlerësuan ndikimet duke marrë parasysh angazhimet e mëtejshme të zbutjes të integruara në hartimin dhe funksionimin e Projektit. Ky proces përsëritës vazhdoi derisa një ndikim u mendua i pranueshëm brenda kufijve të asaj çfarë shihej të ishte teknikisht dhe financiarisht e realizueshme si dhe kosto-efektiv.

 	Faqja 19 nga 22					
	Kodi Zonal	Kodi i Kompjut erit	Kodi i Sistemit	Kodi i Disc.	Lloji i Doku mentit	Numri i Serisë
Titulli i Projektit:	Gazsjellësi Trans Adriatik – TAP					AAL00-ERM-641-Y-TAE-1007 Rish.: 03
Titulli i Dokumentit:	VNMS Shqipëri					
	SEKSIONI 5 – Stili dhe metodologjia e VNMS					

Të gjitha ndikimet reziduale të rëndësishme përshkruhen në Raportin e VNMS-së lidhur me rëndësinë e tyre të përgjithshme. Aty ku dëmi është i një rëndësie më shumë se sa minore, VNMS-ja shpjegon në mënyrë më të detajuar se si është zbatuar hierarkia e zbutjes (dhe aty ku është e përshtatshme mundësitë e tjera të zbutjes të marra në konsideratë në vlerësim, dhe arsyet për refuzimin e tyre) për të pakësuar pasojat deri në një nivel që shihet të jetë i pranueshëm.

Shkalla e rëndësisë që i atribuohet pasojave të mbetura (Reziduale) lidhet me peshën që ekipi i VNMS-së konsideron që duhet t'u jepet atyre në marrjen e vendimeve mbi Projektin dhe në hartimin e kushteve.

Kuadrati 5.7-1 Rëndësia e Ndikimeve Reziduale

Çdo **ndikim** rezidual **madhor**, pavarësisht nëse është pozitiv apo negativ, konsiderohet se justifikon peshë thelbësore, kur krahasohet me kostot dhe përfitimet e tjera mjedisore, sociale ose ekonomike, për ata që marrin vendime mbi Projektin; do të pritet të vendosen kushte për të siguruar që ndikimet e pafavorshme të kontrollohen dhe monitorohen në mënyrë strikte dhe të ofrohen plotësisht ndikimet e dobishme.

Ndikimet reziduale të moderuara konsiderohen të jenë të një rëndësie më të vogël në marrjen e vendimeve, por gjithsesi justifikojnë vëmendje të kujdesshme ndaj kushteve në lidhje me zbutjen dhe monitorimin, për të siguruar përdorimin e teknikave më të mira të disponueshme për t'i mbajtur ndikimet e pafavorshme brenda kufijve që mendohen se janë të pranueshme dhe për të siguruar ofrimin e ndikimeve pozitive.

Ndikimet minore sillen në vëmendjen e vendimmarrësve por identifikohen sikur justifikojnë pak, në mos aspak peshë në vendim; zbutja do të arrihet duket përdorur praktikën normale të mirë dhe do të pritet të kryhet për të konfirmuar që ndikimet nuk i tejkalojnë nivelet e parashikuara.

5.7.6 Akumulimi i Pasojave

Në kontekstin e Projektit TAP, pasojat e akumuluarat pozitive ose negative¹ që vijnë nga burime të ndryshme ose nga i njëjti burim dhe që prekin një receptor specifik mjedisor, social ose kulturor do të merren në konsideratë gjatë vlerësimit të ndikimeve të identifikuar. Ku të jetë e përshtatshme, do të përcaktohet efekti i tyre i kombinuar mbi receptorin.

Për më tepër, pasojat e akumuluarat që mund të ndodhin nga efektet e kombinuara të Projektit TAP me aktivitete të tjera që po ndodhin aktualisht ose që janë logjiksht të parashikueshme në të ardhmen në zonën e projektit do të merren gjithashtu në konsideratë dhe do të vlerësohen në *Seksionin 8.22*.

Vlerësimi i pasojat e akumuluarat do të kryhet, në terma të përgjithshëm, në mënyrë cilësore në bazë të informacionit ekzistues të aktiviteteve të tanishme ose të ardhshme të marra në konsideratë dhe gjykimit të ekipit të VNMS-së.

¹ Ndikimet kumulative krijohen kur efektet e një veprimi u shtohen ose ndërveprojnë me efekte të tjera në një vend të caktuar dhe brenda një kohe të caktuar. Pra ndikimet kumulative të një veprimi ose aktiviteti mund të shihen si efektet totale mbi një burim, ekosistem, ose komunitet njerëzor të atij veprimi dhe të të gjitha aktiviteteve që ndikojnë mbi atë burim (US EPA, 1999, shih: <http://www.epa.gov/compliance/resources/policies/nepa/cumulative.pdf>)

 	Faqja 20 nga 22					
	Kodi Zonal	Kodi i Kompjuterit	Kodi i Sistemit	Kodi i Disc.	Lloji i Dokumentit	Numri i Serisë
Titulli i Projektit: Gazsjellësi Trans Adriatik – TAP	AAL00-ERM-641-Y-TAE-1007					
Titulli i Dokumentit: VNMS Shqipëri	Rish.: 03					
SEKSIONI 5 – Stili dhe metodologjia e VNMS						

5.7.7 Ndikimet Ndërkufitare

Termi ndikim ndërkufitar i referohet një ndikimi i cili ndodh përmes kufijve politikë, qoftë për shkak të lëvizjes së një artikulli me ndikim (si një mbetje) përtej kufijve të lartpërmendur; ose për shkak të një diçkaje, e cila në vetvete është me natyrë ndërkufitare, mbi të cilën ushtrohet ndikim (si emetimet atmosferike).

Në kontekstin e Projektit TAP, i cili është planifikuar të kalojë përgjatë Republikës së Shqipërisë nga lindja në perëndim (nga kufiri me Greqinë deri në Detin Adriatik), duhet të merren në konsideratë ndikimet ndërkufitare. Aspektet kyçe që duhen marrë në konsideratë kur analizohen ndikimet ndërkufitare të mundshme të lidhen me ndikimet e TAP-it mbi ndikimet mbi burimet biologjike (kryesisht popullatat e zogjve migrues dhe mishngrënësit e mëdhenj); peizazhet dhe aspektet pamore, dhe zhurma dhe emetimet e ajrit nga CS02 (vendosur pranë kufirit Shqipëri-Greqi).

Metodologjia e përdorur për të vlerësuar rëndësinë e ndikimeve ndërkufitare të mundshme do të jetë e njëjtë me atë të përdorur për të gjitha llojet e ndikimeve.

5.7.8 Menaxhimi dhe Monitorimi

Në VNMS është identifikuar një gamë e gjerë masash të ndryshme për të zbutur ndikimet dhe TAP AG është zotuar në zbatimin e tyre. Këto masa janë përcaktuar në Përshkrimin e Projektit për masat e brendshme të hartimit dhe në seksionet e zbutjes për njësitë specifike të zbutjes. Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS) përshkruan se si do të përmbushen zotimet e zbutjes së bashku me rolin e monitorimit, inspektimit, auditimit dhe raportimit. Ku është e nevojshme, jepen detaje shtesë për çështjet e rëndësisë kritike në formën e planeve të përvijuara specifike për temën (p.sh. për menaxhimin e mbetjeve).

5.8 Përballja me Pasiguritë dhe Vështirësitë e Hasura gjatë Ndërmarrjes së VNMS-së

5.8.1 Konsiderata të Përgjithshme

Ashtu si shumica e VNMS-ve për projekte të mëdha, VNMS-ja e TAP-it u përball me disa sfida lidhur me marrjen e informacionit bazë, saktësinë e nivelit të parashikimit të pasojave dhe hartimin e masave të duhura për zbutjen e tyre. Për më tepër, edhe me një hartim të qëndrueshëm të Projektit dhe një mjedis të pandryshueshëm, parashikimet sipas përkufizimit janë të pasigurta.

Me qëllim lehtësimin e vendim-marrjes, zonat e pasigurisë, boshllëqet dhe deficitet në të dhëna, dhe puna shtesë që u nevojit gjatë stadeve të mëtejshme të hartimit të Projektit janë theksuar brenda raportit të VNMS-së dhe burojnë kryesisht nga çështjet e shtjelluara më poshtë (për një shtjellim më të detajuar të vështirësive dhe kufizimeve shiko *Shtojcën 5*).

  <small>Trans Adriatic Pipeline</small>	Faqja 21 nga 22					
	Kodi Zonal	Kodi i Kompjuterit	Kodi i Sistemit	Kodi i Disc.	Lloji i Dokumentit	Numri i Serisë
Titulli i Projektit:	Gazsjellësi Trans Adriatik – TAP					AAL00-ERM-641-Y-TAE-1007 Rish.: 03
Titulli i Dokumentit:	VNMS Shqipëri					
	SEKSIONI 5 – Stili dhe metodologjia e VNMS					

5.8.2 Vështirësitë dhe Pasiguritë në lidhje me Kushtet Bazë

U kryen studime të ndryshme fizike, gjeoteknike, biologjike dhe arkeologjike në zonën e studimit nga shkencëtar të afirmuar me njohuri të detajuara mbi Shqipërinë. Ka pasur gjithashtu grumbullim të konsiderueshëm të dhënash mbi kushtet socio-ekonomike në këtë zonë. Studimet dhe grumbullimi i të dhënave u planifikuan në një mënyrë të tillë që të kënaqnin të gjitha nevojat e informacioneve lokale specifike. Studimet u përputhën me standardet dhe praktikën e përcaktuara shqiptare për grumbullimin e të dhënave bazë dhe protokollove specifike përkatëse, por gjithashtu u hartuan dhe u ndërmorën që të ishin të përshtatshme për një VNMS ndërkombëtare. Informacioni i grumbulluar kombinoi studimet në terren dhe konsultimet me burimet dytësore të të dhënave, *d.m.th.* kërkoi masën e gjerë të informacionit të disponueshëm në literaturën shkencore, literaturën e papublikuar dhe dokumentet e OJQ-ve dhe ato qeveritare.

Pavarësisht përpjekjeve të mëdha të bëra në grumbullimin e të dhënave bazë, është e pashmangshme që të mbeten disa boshllëqe në njohuri. Në të tilla raste, është përdorur informacioni mbi mjedise të ngjashme ose gjykimi i ekspertëve, së bashku me zbatimin e një përqasjeje konservative kundrejt vlerësimit të rëndësisë së ndikimit aty ku është e përshtatshme.

Shkalla me të cilën një pasiguri e tillë ka ndikuar mbi vlerësimin e ndikimeve trajtohet në *Shtojcën 5*.

5.8.3 Evoluimi i Hartimit të Projektit

Ndërsa VNMS-ja është përgjithësisht një proces që ndërvepron me hartimin, ai mbështetet në hartim në një nivel logjikisht konkret që të dhëna të caktuara të sigurojnë bazën për vlerësimin e ndikimit. Në një projekt të shkallës dhe kompleksitetit të TAP-it, në mënyrë të pashmangshme, kishte çështje që mbeten akoma për t'u zgjidhur plotësisht lidhur me natyrën precize të aktiviteteve të projektit. Shumica e këtyre janë të lidhura me ndërtimin. Në veçanti, VNMS-ja mbështetet në një koncept logjistik paraprak që do të hartohet në mënyrë të detajuar nga kontraktori kryesor vetëm në një stad të mëvonshëm.

Aty ku stadi në procesin e hartimit çon në pasiguri që është material për gjetjet e VNMS-së, kjo është pohuar qartë dhe në disa raste janë vlerësuar më shumë se një mundësi. Përqasja e përgjithshme ka qenë të hidhet një vështrim konservator ndaj ndikimeve reziduale të mundshme, për të identifikuar standardet e performancës të cilat do të plotësojë Projekti aty ku nuk mund të bëhen parashikime të qëndrueshme, dhe të propozojë masa të mëtejshme monitoruese dhe emergjence.

 	Faqja 22 nga 22					
	Kodi Zonal	Kodi i Kompjuterit	Kodi i Sistemit	Kodi i Disc.	Lloji i Dokumentit	Numri i Serisë
Titulli i Projektit: Gazsjellësi Trans Adriatik – TAP Titulli i Dokumentit: VNMS Shqipëri SEKSIONI 5 – Stili dhe metodologjia e VNMS	AAL00-ERM-641-Y-TAE-1007 Rish.: 03					

5.8.4 Saktësia e Parashikimit të Ndikimeve dhe Efektiviteti i masave Zbutëse

Saktësia e parashikimit të ndikimeve preket nga çështjet e diskutuara më lart, së bashku me teknikën parashikuese të përdorur. Kjo vjen pjesërisht ngaqë parashikimet e VNMS-së janë bërë duke përdorur metoda që variojnë nga vlerësimi cilësor dhe gjykimi i ekspertëve deri tek modelimi sasior. Saktësia e parashikimeve varet nga metoda e vlerësimit dhe cilësia e të dhënave hyrëse mbi Projektin dhe kontekstin e tij mjedisor dhe social. Aty ku janë bërë supozime, natyrat e pasigurive, të cilat burojnë nga këto, janë paraqitur në seksionet e temave specifike të Raportit të VNMS-së. Në të gjitha rastet, kriteret e rëndësisë janë zbatuar në mënyrë konservatore për të siguruar që efektiviteti i zbutjes të mos mbivlerësohet.

5.8.5 Menaxhimi i Pasigurisë

Menaxhimi i pasigurisë reziduale është një rol kyç i PMMS. Do të monitorohen ndikimet, si dhe efektiviteti i zbutjes. Aty ku ndikimet gjenden se janë në nivele të larta të papranueshme dhe/ose zbutja dështon në arritjen e objektivave të saj, do të zbatohen veprime korrigjuese.

Trans Adriatic Pipeline AG – Albania (Branch Office)
Torre Drin, Rruga Abdi Toptani
Tirana, Albania
Tel.: + 355 44 306 937
Fax: + 355 42 265 685

esia-comments@tap-ag.com
www.tap-ag.com

Date 01/2013

Copyright Reserved: This document may not be copied, shown to or placed at the disposal of third parties without prior consent of TAP AG.
The latest version of the document is registered in the TAP Project's Database.